

## **E tmerrshme: Shtyn gruan me mbulesë para trenit (Video)**

Krijuar: Premte, 13 Nentor 2015 22:35

---

Ky është momenti tronditës i një gruaje të veshur me hixhab, e cila u shty nga një njeri i moshuar në shinat e trenit, që vinte përballë në metronë e Londrës.

Në video e mëposhtme shihet se si i moshuari, teksa afrohet tek gruaja myslimane dhe e shtyn atë papritmas në trenin që vinte, duke e përplasur me të.

Videoja është filmuar nga kamerat e sigurisë në stacionin e metrosë, transmeton BW.

Policia ka arritur të identifikojë dhe të arrestojë personin e moshuar, i cili është 81-vjeçari, Yoshiyuki Shinohara.

Për fat të mirë gruaja nuk pësoi asgjë, vetëm disa dëmtime të lehta.